



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 4869/prot.

Himarë , më 24.10 . 2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 41 datë 24.10/2023

PËR:

**“ MIRATIMIN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TE PERGJITHSHEM
VENDOR, TE BASHKISE HIMARË “**

Baza Ligjore : Ligji nr.139/2015 date 17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 22, pika 2, nenit 13, pika b te Ligjit nr.107/2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe akteve neligjore te tij, neni 11, V.K.M-se nr.686, “Per miratimin e rregullores se Planifikimit te Territorit”; date 22.11.2017; Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare miratuar me Vendim te K.K.T-se nr.2 date 16.10.2017, te zbardhur si dokument me date 19.03.2018 dhe rregulloreve perkatese te ketij Plani; si edhe interesit te banoreve nga monitorimi i kerkesave te tyre;

VENDOSA:

Miratimin e nismës për rishikimin e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare miratuar me Vendim te K.K.T-se nr.2 date 16.10.2017, te zbardhur si dokument me date 19.03.2018.

KRYETARI I BASHKISË

JORGO GORO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4869/2 prot.

Himarë , më 24.10 . 2023

RELACION SHOQËRUES

PËR:

PROJEKTVENDIMIN E “ MIRATIMIT TË NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHEM VENDOR, TË BASHKISË HIMARË “

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>HYRJE</u>	2
<u>BAZA LIGJORE</u>	3
1. <u>QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT</u>	4
2. <u>DOKUMENTET, PJESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT</u>	5
3. <u>EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË</u>	6
4. <u>PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE</u> ..	6
5. <u>PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT</u>	7
6. <u>PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË</u>	8

HYRJE

Bashkia Himare ndodhet në Shqipërinë e Jug-Perendimore. Ajo përbëhet nga tre Njësi Administrative, respektivisht: Njesia Administrative Himare; Njesia Administrative Lukove; Njesia Administrative Hor-Vranisht. Bashkia ka një sipërfaqe prej 571.94 km² dhe një popullsi prej 27168 banorë.

Karakteristikat gjeografike/territoriale

Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës Horë-Vranisht. Një bashki e pasur me burime ekonomike me përqendrim të turizmi, peshkimi, blegtoria dhe ullishtet. Bashkia e re ndahet në dy territore shumë të ndryshme: Zona bregdetare si dhe Zona e ish-komunës Horë-Vranisht, një zonë e thyer malore e cila aktualisht nuk lidhet me qendrën e Bashkisë me rrugë moderne të drejtpërdrejtë, por vetëm me një rrugë historike mushkash e cila aktualisht nuk është e përdorshme. Bashkia e Himarës përveç burimeve të mëdha të turizmit detar disponon resurse të mëdha edhe në turizmin kulturor apo të natyrës.

Resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

Ne mbarë krahinën e Himarës mbisundon klima Mesdhetare. Nga verilindja vargu i Karaburunit dhe i Çikës (malet Akrokeravne) e mbrojnë atë nga murlani dimëror. Me këtë pozicion klimaterik krahina e Himarës, në tërësi me toka të pakta bujqësore, ka kultivuar kurdoherë, përveç blegtorisë, dy kulturat kryesore mesdhetare: ullinjtë dhe agrumet, pa përjashtuar vreshtat. Pozicioni gjeografik i ka detyruar banorët e krahinës të lidhen nga pikëpamja ekonomike jo vetëm me tokën, por edhe me .

Himara ndodhet në faqen e vargmalit të Cikes dhe peisazhi i saj karakterizohet nga kurrizi ujendares dhe erozioni i kreshtes. Perceptimi është që mali ndodhet larg bregut të detit dhe vija bregdetare zgjerohet dhe gradualisht kalon nepermjet disa luginave, kodrave dhe qepeve të vegjel.

Karakteristikat historike

Emri Himarë e ka origjinën nga fjala Greke "Χείμαρρος" që do të thotë Prrua dhe perkon me vendosjen gjeografike të Himarës mbi Prrua që zbret nga vargmalet e Acrocherauneve, ose sic quhet sot, (Malet e Vetetimes). Por emri Himare, besohet se vjen nga emri i një kafshe të përmendur në mitologjinë e lashtë të quajtur Chimera e cila ishte një Luan ku në shpatullën e majte të tij dilte koka e një Dragoi dhe në shpatullën tjetër koka e një dhie gjigante, ndërsa mbi shtyllën kurrizore ishte një gjarpër me dy koka që dilnin simetrikisht me tri kokat e tjera në trupin e kafshës gjigante. E ndërtuar në pjesën jugore të bregdetit shqiptar, qyteza e Himarës ka qenë gjithmonë qendër e një zone që ka përfshirë jo vetëm fshatrat e jugut, por edhe Labërinë e Kurveleshin. Ajo përmendet që në kohët e lashta ku paraardhësit ishin fisi Ilir i Kaonëve, por historia moderne duket se fillon në 1199, kur në qytet u vendos sundimi i Venedikasve. Fqinjët tanë veriorë nuk mundën ta mbanin për shumë kohë dhe në shekullin e XIII zona e Himarës u përfshi nga Karli i Anzhuinëve. Zona ka qenë gjithmonë me një popullsi autoktone.

Më 1431 Himara u përfshi nga Perandoria Turke si një krahinë e Sanxhakut të Shqipërisë. Në 1482 disa familje u larguan nga qyteti për në Sicilinë, dhe atje u është dhënë tokë në afërsi të qytetit të Palermos, banorët e të cilit mirëmbajnë zakonat, veshjet popullore dhe besimi orthodhoks. Duke filluar që nga shekulli i XVI, si pasojë e disa kryengritjeve, Himara, siguroi një sërë privilegjesh dhe një lloj autonomie, që e lejoi të ruante fenë. Fatkeqësisht, mungesa e rrugëve dhe zona malore krijoi vështirësi në komunikimin e saj me zonat e brendshme të vendit.

BAZA LIGJORE

Baza Ligjore : Ligji nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligj nr.107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar dhe akteve neligjore te tij, V.K.M-se nr.686, "Per miratimin e rregullores se Planifikimit te Territorit"; date 22.11.2017; Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare miratuar me Vendim te K.K.T-se nr.2 date 16.10.2017, te zbardhur si dokument me date 19.03.2018 dhe rregulloreve perkatese te ketij Plani; si edhe interesit te banoreve nga monitorimi i kerkesave te tyre;

këshillimin e projekt dokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;

botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në **Ligjin Nr. 107/2014** "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, **VKM Nr. 686, datë 22.11.2017** "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Me Vendimin Nr. 2 datë 16.10.2017 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himare. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me nevojën e bashkisë për:

Përgjigjes se kerkesave te interesit te banoreve dhe te bizneseve(**132 kerkesa**), dale nga monitorimi i tyre si dhe kerkesave te ardhura nga AKPT dhe AZHT ne kuadrin e

permiresimit te sherbimeve ne zonen me rendesi kombetare si dhe investimeve strategjike. Pershtatjen e Planit te Pergjithshem Vendor me kerkesat aktuale te zhvillimit te turizmit ne zone si dhe fokusimin ne zhvillimin ekonomik te zones. Lehtesimin e procedurave te sherbimit ndaj komunitetit nga veshtiresi te hasura gjate implementimit te procedurave te hasura ne zbatimin e PPV. Keto ndryshime do te sjellin permiresim ne zhvillimin e turizmit ne zone si dhe zhvillimin e saj ekonomik.

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, PPV e rishikuar do të zgjidhë problematika që lidhen edhe me: zgjerimin njëjësive te banimit per zhvillimin e fshatrave; permiresimin e pikave te caktuara te rregullores se PPV; korrektimin e gabimeve, mosperputhjeve apo lapsuseve; si dhe përmirësimin e disa kufijve te njëjësive strukturore ne përshtatje me kërkesat e shqyrtuara, zgjerim me përfshirjen e zonave te reja.

Stafi i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë bashkisë Himare ka analizuar me vemendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkisë për çështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim: përmirësimin e mëtejshëm te përmbajtjes se rregullores se PPV ne shërbim te lehtësisë ne zbatim; reflektimin e kërkesave te ardhura ne drejtimin te Bashkise Himare per nevoja te komunitetit per zhvillim; si dhe rishikimi i disa kufijve te njëjësive strukturore ne zonat me potencial te madh zhvillimi.

2. DOKUMENTET, PJESE E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidentuar që dokumentet që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV janë:

1. Plani i zhvillimit te territorit, ku perfshihen:

- a. plani i perdorimit te tokes;
- b. hartat shoqeruese te planit;

2. Rregullorja e planit, ku jepen:

- a. kodifikimi;
- b. rregullat e pergjithshme te perdorimit te tokes;
- c. rregullat per cdo njesi, te cilat perfshijne kushtet dhe koeficientet e zhvillimit per njesite strukturore, objekt rishikimi

Përmbajtja e dokumentit të rishikuar të PPV do të bazohet në VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përmbajë:

- Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:

- a) ndërhyrjet në nenet e Rregullores vendore të Planit;
- b) ndërhyrje në pasaportat e njësisve strukturore;
- c) etj, sipas analizimit të detajuar Planit të Përgjithshëm Vendor.

- Shtojcat përkatëse;

- Datamodel GIS me atributet përkatëse.

Dokumentacioni i përgatitur në kuadër të procedurës së rishikimit të PPV këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Rregjistrisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (RKPT).

3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokumenti i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i Bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, përbëhet nga ekspertë të fushave:

- Të planifikimit të territorit;
- Të informacionit gjeohapësinor;
- Të mjedisit; (ekspert i jashtëm)
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës listohet si më poshtë:

1. Gentian Stratoberdha (*Drejtor i DPZHT*)
2. Elvira Marko (*Përgjegjëse në DPZHT*)
3. Ilir Dhimojani (*specialist DMMT*)
4. Klejli Muharremi (*Jurist*)

Grupi i punës do të marrë në konsideratë kërkesat e ardhura në adresë të Bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-se, do të shqyrtojë dhe do të propozojë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisë relacionet përkatëse.

4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet

autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:

- a. *Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.*
- b. *Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.*
- c. *Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.*
- d. *Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.*
- e. *Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.*

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë Himare.

Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- b. Bashkia do të këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;

- c. Vendimi i KESHILLIT BASHKIAK, për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.
- d. Vendimi i KB për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- e. Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.

6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË

Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të Bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.

Konkretisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia nuk propozon të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor.

Konceptoi: G.Stratobërdha (Drejtor)



KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

